

**STATUT**  
**BODE FOOTBALL MANAGEMENT SH.P.K**

**KREU I**  
**THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA**

**Neni 1**  
**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesi**

Sot, më datë 4 Qershor 2018, shtetasit :

- a) **Franci Bode**, i biri i Alfredit dhe i Edlirës, lindur më datë 29.06.1989, në Berat, Shqipëri dhe banues në Tiranë, adresa: Rr. Qamil Guranjaku, L. 1, P. 4, Shk. 3, Ap. 41, email: [franci@bfm.al](mailto:franci@bfm.al), Nr. Cel: +355 69 28 02 626, posedues i mjetit të identifikimit tip: Pasaportë me Nr. BA3576109, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar (i njojur si: ORTAKU I PARË) dhe
- b) **Lorin Burba**, i biri i Gramosit dhe i Naimes, me datëlindje 27.06.1989, lindur dhe banues në Tiranë, adresa: Rr. L. Qesarakë, Rr. Dalip Topi, P. Zaimaj, Shk. 1, K. 6, Ap. 22-25, email: [lorinburba@gmail.com](mailto:lorinburba@gmail.com), Nr. Cel: +33 7 53 44 17 28, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar (i njojur si: ORTAKU I DYTË),

vendosën krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar Bode Football Management SH.P.K

**Neni 2**  
**Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

1. Përfaqësim të sportistëve profesionist ose amator të regjistruar pranë klubeve sportive vendase dhe të huaja, në negociata për punësimin ose transferimin e tyre pranë këtyre subjekteve.
2. Konsulencë për zhvillimin dhe menaxhimin e karrierës për sportistë profesionist ose amator të regjistruar pranë klubeve sportive vendase dhe të huaja.
3. Përfaqësim të sportistëve profesionist dhe amator pranë organeve juridike sportive vendase dhe të huaja.
4. Ndërmjetësim ndërmjet klubeve sportive vendase ose të huaja dhe sportistëve profesionist ose amator për punësimin ose transferimin e tyre.
5. Adminstrim, përfaqësim, konsulencë dhe ndërmjetësim për administrimin e të të drejtave personale jo-pasurore të lidhura me imazhin e shoqërive tregtare sportive, klubeve sportive dhe sportistëve profesionist ose amator, vendas apo të huaj.
6. Komercializimin e logove dhe brand-eve të shoqërive tregtare sportive, klubeve sportive dhe sportistëve profesionist ose amator, vendas apo të huaj.
7. Marketingun dhe promovimin e sportistëve profesionist të regjistruar pranë klubeve sportive vendase dhe të huaja për transferimin e të drejtave sportive dhe ekonomike mbi Kartonin e Lojtarit (shitje, huazim, shkëmbim).
8. Krijimin e partneriteteve me agjenci marketingu ose sportive vendase dhe të huaja me qëllim tregtimin e produkteve sportive, transferimin e sportistëve profesionist.
9. Çdo aktivitet tjeter të njojur me ligj.

**Neni 3**  
**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.



**Neni 4**  
**Selia, Website dhe adresa elektronike**

1. Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën L. Qesarakë, Rr. Dalip Topi, P. Zaimaj, Shk. 1, K. 6, Ap. 22-25, Tiranë, Shqipëri.
2. Website i shoqërisë do të jetë: [www.bfm.al](http://www.bfm.al).
3. Adresa elektronike e shoqërisë do të jetë: [franci@bfm.al](mailto:franci@bfm.al).

**KREU II**  
**KAPITALI**

**Neni 5**  
**Kapitali themeltar**

1. Kapitali themeltar i shoqërisë ka një vlerë prej ALL 1,000.00 (një mijë lekë) e përbërë nga 1 (një) kuotë, me vlerë nominale ALL 1,000.00 (një mijë lekë) e zotëruar nga ortakët si mëposhtë:
  - a) Franci Bode do të zotërojë 90 % (nëntëdhjetë përqind) të kuotës së kapitalit themeltar të shoqërisë;
  - b) Lorin Burba do të zotërojë 10 % (dhjetë përqind) të kuotës së kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Kontributi i ortakëve është në para dhe vlera integrale e kapitalit themeltar është nënskruar dhe shlyer menjëherë.

**Neni 6**  
**Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**

1. Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënskrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.
2. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.
3. Në të gjitha rastet zvogëlimi e prek ortakun në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

**Neni 7**  
**Transferimi i kapitalit**

1. Kuatat e kapitalit të shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
  - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - b) shitblerjes;
  - c) trashëgimisë;
  - d) dhurimit;
  - e) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.
2. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve (nëse do të ketë të tjerë), për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.
3. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

**KREU III**  
**ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

**Neni 8**  
**Organi Vendimmarres**

1. Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
2. Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteve te peraktuara ne ligj.
3. Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
  - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshire përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - g) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - h) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - i) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - j) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - k) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
4. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
5. Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
6. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

**Neni 9**  
**Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme**

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

**Neni 10**  
**Kuorumi**

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
2. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

3. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

**Neni 11**  
**Marrja e vendimeve**

1. Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zgjedhimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
2. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :
  - a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - ç) përcaktimin e shpërblimeve
  - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë; përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - e) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - f) Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

**Neni 12**  
**Përjashtimi nga e drejta e votës**

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
  - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
  - d) dhënen ose jo të përfitimeve të reja.
2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesit, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

**Neni 13**  
**Administrimi**

1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
2. Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
3. Ortakët e shoqërisë emërojnë në cilësinë e **Administratorit të parë**, i cili do të jetë ushtrojë kompetencat e njohura nga Neni 14 i këtij statuti dhe nga legjislacioni shqiptar në fuqi **për një periudhë 5-vjeçare, duke filluar nga regjistrimi i shoqërisë, shtetasin Franci Bode**, i njohur si Ortaku i Përë i Bode Football Management sh.p.k (të dhënat identifikuase të Ortakut të Parë gjenden të pasqyruara në Nenin 1 të këtij statutit).

**Neni 14**  
**Kompetencat e Administratorëve**

1. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
  - a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
  - c) kujdesen përmbytjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet përmirësuese, i paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme përmiratim;
  - e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përmiratim, që ka qenë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - f) kryejnë regjistimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin përmirësuar të Regjistrimit;
  - g) raportojnë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë përmiratim; tregtare;

- h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
2. Administratoret Jane te detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshme, në rastet kur:
    - a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim. - shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
    - b) shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
  3. Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.
  4. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërbimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

### **Neni 15 Pergjegjesite e Administratorit**

1. Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
2. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:
  - a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesid;
  - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - d) të parandalojë dhe mënjanjojë rastet e konfliktit, prezant apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
  - e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
3. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
4. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij nenit, eshte i detyruar t'i dëmshpërtlejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
5. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpërtlejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit « Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare », kryen veprimet e mëposhtme:
  - a) u kthen ortakëve kontributet;
  - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
  - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

- d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikojë që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- e) jep kredi.
- 6. Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.
- 7. Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkësë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

## **KREU IV VITI FINANCIAR-EKSPERTET**

### **Neni 16 Viti Financiar**

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

### **Neni 17 Ekspertet**

1. Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithvejetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer një gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.
2. Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar percatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtës vendimore qe ka.

## **KREU V PRISHJA –RIORGANIZIMI I SHOQËRISË**

### **Neni 18 Prishja dhe likuidimi**

1. Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :
  - a) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
  - b) me hapjen e procedurave të falimentimit;
  - c) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përpunhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
  - d) me vendim të gjykatës;
2. Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese “Shoqeri ne likuidim e siper”.
3. Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

4. Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**Neni 19**  
**Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

**Neni 20**  
**Baza Ligjore**

1. Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
2. Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

**Neni 21**  
**Mosmarrëveshjet**


Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE**

FRANCI BODE



LORIN BURBA



## **DEKLARATË**

Sot, më datë 04.06.2018, në përputhje me Ligjin Nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” dhe Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” (i ndryshuar) dhe në zbatim të Statutit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar Bode Football Management sh.p.k,

Unë, i nwnshkruari **Franci Bode**, i biri i Alfredit dhe i Edlirës, lindur më datë 29.06.1989, në Berat, Shqipëri dhe banues në Tiranë, adresa: Rr. Qamil Guranjaku, L. 1, P. 4, Shk. 3, Ap. 41, email: [franci@bfm.al](mailto:franci@bfm.al), Nr. Cel: +355 69 28 02 626, posedues i mjetit të identifikimit tip: Pasaportë me Nr. BA357610

### **DEKLAROJ:**

- 1- Se do të ushtroj funksionet e Administratorit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar Bode Football Management sh.p.k më përgjegjësi, besnikëri dhe në respekt të dispozitive ligjore shqiptare në fuqi.
- 2- Për efekt deklarimi, vendos në dispozicion specimenin e firmës time, e cila gjendet në këtë akt.

**DEKLARUESI  
FRANCIBODE**

